



I N F O R M A C I O N

Mbi incidentin e ndodhur ne Raden e Jashtme

te Portit te Hidrokarbureve

“ Romano- Port “ sha

me Anijen Turke “ EDIRNE “ ne datet 15.01.2012.

Me date 15.01.2012, rreth ores 13.33 u degjuan 2 (dy) shperthime te njepasnjeshme te fuqishme te shoqeruara me nje lemsh te madh zjarri e tymi, te cilat vinin nga drejtimi i vend - ancorimit te anijes Turke “ EDIRNE “ 2 -3 milje jashte rades **se Portit te Hidrokarbureve “Romano Port” sha**, Durres.

Informacioni u dha dhe u konfirmua njeheresh nga Sherbimet e Sigurise se “ Romano Port “ sha ne oren 13.33 te dates 15.01.2012.

Nga ora 13.34 deri ora 13.37 u be lajmerimi me telefon i te gjithe **Enteve Mbeshtetese te Forcave te Sigurise se “Romano Port” sha :**

- 1. Salla Operative e Drejtorise se Policise Kufitare**
- 2. Drejtorise se Policise se Rendit**
- 3. Kapitenerise se Pergjitheshme te Porteve**
- 4. Repartin e Zjarrfikseve**
- 5. Drejtorise se Spitalit**
- 6. Autoritetin Shteteror te Sigurise Portuale**
- 7. Ministrine e Puneve Publike dhe Transporteve**

Drejtuesit e Forces se Sigurise Portuale “ Romano Port “ sha ne bashkeveprim me **Administratorin e Kompanise “ Romano Port “ sha Z. Piro Bare**, mbasi u njohen me situaten , urdheruan **drejtuesin e skafit te Sherbimeve Portuale Z. Avni Almeta** te nisej urgjentisht ne drejtim te vend - ankorimit te anijes “ EDIRNE “ qe rrezikohej nga casti ne cast te mbytej.

Nisja e skafit u be ne oren 13:40 dhe mberitja ne vend - ngjarje rreth ores 13:50, saktesisht 4 - 5 min para fundosjes se anijes. Theksojme qe situata detare ishte me valezim dallgesh me forcen 5 – 6 balle duke e bere mjaft te veshtire.

Sipas informacionit te drejtuesit te skafit z. Avni Almeta situata ne vend -ngjarje ishte mjaft e rende. Ekuipazhi i mbijetuar luftonte jo vetem me dallget qe intensifikoheshin nga casti ne cast, por edhe vorbullen thithese qe krijoheshin nga mbytja e anijes. Ata te gjithë se bashku kishin hipur ne varken e shpetimit te anijes “EDIRNE” dhe afrimi i skafit (me shume veshtiresi) beri te mundur imbarkimin ne bord te 12 pjestareve te ekuipazhit , ndersa varken e tyre e rimorkiuan me skafin.

Skafi me te 12 te mbijetuarit mberriti ne kalaten jugore te “Romano Portit”sha ne oren 14:38. Pritja e tyre u be nga te gjitha Autoritetet. Ne keto momente u be identifikimi i tyre nga Sherbimi i Sigurise nga ku rezultoi qe nga i gjithë ekuipazhi prej 15 personash , mungonin 3 veta, midis tyre dhe Kapiteni i anijes Z. Khayyam Mammadov. Me ndihmen e furgonit te Policise ekuipazhi u nis per ne Spitalin e Durrës, meqenese Ambulanca arriti disa minuta me vonë.

Ne oren 14:30 nisi operacioni i kerkim –shpetimit te 3 personave te humbur. Ne perberje te ketij ekipi gene dy rimorkiature te Portit te Durrës, Mjeti i Policise Kufitare si dhe Roja Bregdetare.

Operacioni vazhdoi deri ne oren 17:30 kohe ku po veprohej ne kushtet e erresires. Gjate kesaj periudhe kohe u gjenden trupat e pajete te dy personave, nga tre personat e humbur.

Disa te dhena mbi Anijen “ Edirne “ dhe ekuipazhin :

Anija Turke “EDIRNE” ishte me flamur te SIERRA LEONE, me port regjister FREETOWN. Anija cisterne “ EDIRNE” me IMO 7704291 me DWT of 2,121 tone, me Nivel sigurie Nr.1 dhe Afati i Certifikates se Sigurise deri 25/12/2015 ishte prodhuar ne vitin 1977. Operatori i anijes eshte Saygi Denizcilik Ve Elektrik.

Anija hyri ne Portin e Hidrokarbureve te “Romano Port “ sha me date 12/01/12, ora 09:00 per te shkarkuar 3043.8 ton Benzine per Shoqerine “SET SELECT ENERGY” qe operon ne zonen e Porto Romanos. Mbasi ka perfunduar se shkarkuari si dhe ka kryer te gjitha procedurat me Autoritetet e Portit te Hidrokarbureve, eshte larguar nga porti ne oren 13:25 te dates 13/01/12.

Nga data 13.01.2012 deri ne daten 15.01.2012 Anija Turke “EDIRNE” ka qendruar ne raden e jashtme te Portit te Hidrokarbureve, ne PORTO ROMANO, Durrës.

Te dhena per ekuipazhin:

Ekuipazhi perbehej gjithsej nga 15 veta:

6 shtetas Gjeorgjian; 4 shtetas Azerbajxhanas

3 shtetas Turq; 2 shtetas Ukrainas

Shoqeria Koncesionare “Romano Port” sha ngushellon familjet e :

1. Kapitenit nga Azerbajxhani Z. Khayyam Mammadov.
2. Marinareve nga Gjeorgjia Z. Melkaza Lazishvili dhe Beki Urushadze.

Shoqeria Koncesionare “Romano Port” sha Falenderon per gatishmerine e larte:

1. Drejtorine e Policise Kufitare
2. Drejtorine e Policise se Rendit
3. Kapitenerine e Pergjitheshme te Porteve
4. Repartin e Zjarrfikseve
5. Drejtorine e Spitalit
6. Autoritetin Shteteror te Sigurise Portuale
7. Ministrine e Puneve Publike dhe Transporteve

Shoqeria Koncesoinare “Romano Port” sha Falenderon ne menyre te vecante:

1. **Te gjithe Ekipin e “Romano Port” sha** qe u gjend i gatshem duke zbatuar te gjitha Rregulloret dhe Ligjet e Brendshme dhe ato Detare ne menaxhimin e nje situate te tille emergjente, vacenerisht:
2. **Z. AVNI ALMETA** per kurajon qe tregoi duke shpetuar 12 jete njerezore, madje duke vene ne rrezik jeten e tij.

**PAMJE NGA NGJARJA
TE MARRA NGA KAMERAT
E
SHOQERISE KONCESIONARE “ROMANO PORT” SHA**



Shperthimi i Anijes Turke “EDIRNE”



Mbas 7 minutash Skafi i Shoqerise "Romano Port" Sha me drejtues Z. Avni Almeta niset ne drejtim te Anijes "EDIRNE" ne ndihme te ekuipazhit.



Anija Turke "EDIRNE" pak minuta para mbytjes.



Skafi i Shoqerise "Romano Port" Sha me drejtues Z. Avni Almeta duke u kthyer ne Port, mbasi ka mundur te shpetoje 12 persona nga ekuipazhi i Anijes "EDIRNE".



Z. Avni Almeta heroi qe vuri jeten e tij ne rrezik per te shpetuar 12 marinaret e ekuipazhit te anijes "EDIRNE".